

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6502  
E mërkurë, 5 janar 2022  
çmimi 0.40 €

## BKS-ja pagoi mbi 10 milionë euro dëme të shkaktuara nga automjetet në vitin 2021

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

INSTITUCIONET SHËNDETËSORE KANË NJOFTUAR PËR SHTIMIN E RASTEVE ME COVID

# PAS VITIT TË RI SHTOHEN RASTET ME COVID



Raporti i Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKShPK) në 24 orët e fundit ka treguar për shtim të rasteve me Covid-19. Duke u bazuar në këtë raport, Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka treguar se gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar 108 raste të reja të infektimit me koronavirus. MSh-ja ka sqaruar se në kuadër të këtyre shifrave ka raste të mbledhura për tri ditë nga një laborator privat

## AKTUALE



**MUNGESA E RRYMËS RREZIKON INVESTIMET E HUAJA** F. 7

**BËHET VIRALE VIDEOJA E BIDENIT DUKE DALË NGA AEROPLANI NË MES TË NJË STUHIE** F. 6

**SALI BERISHA THËRRET PROTESTË MË 8 JANAR** F. 6

## EKONOMI



**KOSTT-i, KOMPANI LIDERE NË SEKTORIN PUBLIK PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE NDRËKOMBËTARE TË CILËSISË** F. 8

**BIEN ÇMIMET E NAFTËS PËRPARA TAKIMIT TË VENDEVE TË OPEC-ut** F. 8


## SPORT



**ADEMI: TRAJNERI I RI EMËROHET NË MARS, DUHET T'I PLOTËSOJË KËTO KUSHTE** F. 10

## Kriza energjetike ndalon prodhimin e kriptovalutave në Kosovë

FAQE 7



## PRELEC: KURTI, PA STRATEGJI NË DIALOG

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Italia mban zgjedhjet presidenciale më 24 janar

ROMË, 4 JANAR - Politikanët italianë do ta zgjedhin kreun e ri të shtetit më 24 janar. Në Itali, deputetët, senatorët dhe përfaqësuesit e 20 rajoneve, zgjedhin presidentin e republikës. Për të fituar, një kandidat i duhen dy të tretat e votave në tri raundet e para të

votimit.

Në të katërtin një shumicë e thjeshtë është e mjaftueshme. Zgjedhja e pasardhësit të presidentit aktual, Sergio Mattarella, pritet me padurim në Itali. Deri më tani nuk ekziston një emër zyrtarisht.

Për javë të tëra mediet kanë spekuluar për kandidaturën e kryeministrit aktual, Mario Draghi. Të tjerë kanë thënë se do të dëshironin të shihnin një grua në krye të shtetit. Në kampin e krahut të djathtë, Silvio Berlusconi përmendet vazhdimisht si kandidat.

Presidenti ka rol të rëndësishëm në Itali, sidomos në kohë krizash. Në mesin e gjërave për të cilat ka pushtet është edhe shpërndarja e legjislaturës në parlament dhe emërimi i ministrave. Mandati shtatëvjeçar i Mattarelles përfundon në muajin shkurt.



## Holanda do t'i rihapë shkollat pavarësisht prej rasteve të rritjes me Covid

AMSTERDAM, 4 JANAR - Shkollat në Holandë do të rihapen javën e ardhshme, ashtu siç ishte planifikuar, pas një pushimi më të gjatë se zakonisht për Krishtlindje.

Qeveria njoftoi të hënën se shkollat do të hapen megjithëse rastet me koronavirus janë rritur, sidomos ato me variantin Omicron.

Më 19 dhjetor Holanda vendosi disa nga kufizimet më të ashpra në Evropë për ta ndaluar shpërndarjen e shpejtë të Omicronit, duke i mbyllur kështu shkollat për tri javë. Me këto masa u mbyllën edhe të gjitha dyqanet joesenciale si dhe hapësirat argëtuese e kulturore deri më 14 janar. "Rihapja është e përgjegjshme", ka theksuar ministri i Arsimit në Holandë. Derisa shkollat fillore dhe të

mesme do të hapen më 9 janar, institucionet më të larta arsimore do të kufizohen në ligjërata online "për shkak të rritjes së infeksioneve në këto grupmosha", tha ministri.

Adoleshentët e moshës 17 vjeç e poshtë do të lejohen sërish të luajnë sport jashtë deri në orën 20:00 nga java e ardhshme, kur do të vlerësohet sërish situata.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Holandë ka njoftuar se rastet pozitive të koronavirusit po rriteshin, kryesisht për shkak se lloji më infektiv Omicron tani është mbizotërues.

Rreth 14 623 njerëz rezultuan pozitivë të hënën, krahasuar me 11 440 një javë më parë, me shkallën mesatare të infeksionit në rritje për të gjashtën ditë me radhë, ka njoftuar ky institut. Sipas kufizimeve holandeze,



vizitorët janë kufizuar në dy persona në të njëjtën kohë, ndërsa katër për familje ishin të

lejuar gjatë fundjavës së Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri. Grupet e njerëzve jashtë janë të

kufizuar në jo më shumë se dy, por nuk ka pasur asnjë ndalim për lëvizjen e njerëzve.

## Mali i Zi regjistron 450 për qind më shumë raste me koronavirus brenda dy javësh



PODGORICË, 4 JANAR - Autoritetet në Mal të Zi janë duke u përballur me rritje të shpejtë të rasteve të infektimit me koronavirus pas raportimit të rasteve të para të variantit Omicron të këtij virusi.

Më 3 janar autoritetet kanë raportuar për 12 507 raste aktive me koronavirus.

Shtatë ditë më parë shifra e rasteve aktive ka qenë 3 310.

Vetëm në 24 orët e fundit autoritetet kanë regjistruar 1 703 raste të reja.

Instituti i Shëndetit Publik në

Mal të Zi ka thënë se varianti Omicron i koronavirusit, i cili është identifikuar 18 ditë më parë në këtë shtet, është dominues dhe po përhapet më shpejt sesa variantet e tjera. Sipas statistikave, numri i personave të infektuar deri më 3 janar, në krahasim me dy javë më parë, është rritur për gati 450 për qind.

Numri i viktimave është ulur për 11 për qind. "Shumica e pacientëve të rinj janë të grupmoshës 20 deri në 40 vjeç", është thënë në një deklaratë të

Institutit.

Në gjithë shtetin janë hospitalizuar 169 pacientë derisa 29 prej tyre të infektuar me koronavirus janë në rrezik për jetë. Sipas autoriteteve, 44 për qind e popullsisë së Malit të Zi është vaksinuar me dy doza të vaksinës kundër koronavirusit. Mali i Zi ka një popullsi prej 620 000 banorësh.

Prej shpërthimit të pandemisë në këtë shtet janë regjistruar rreth 175 000 raste të infektimit me koronavirus. Prej tyre, 2 420 persona kanë vdekur.

## "Apple" bëhet kompania e parë në vlerë të 3 trilionë dollarëve

NJU-JORK, 4 JANAR - Gjiganti teknologjik amerikan, "Apple", është kthyer në kompaninë e parë që kap vlerën e tre trilionë dollarëve në treg.

Çmimi i aksioneve të kompanisë është rritur për 5 800 për qind prej kur themeluesi dhe ish-shefi

ekzekutiv, Steve Jobs, ka paraqitur telefonin e parë, "iPhone", më 2007. "Apple" është konsideruar si një nga fitueset e pandemisë, pasi shitjet janë rritur gjatë periudhave të izolimit, meqë njerëzit kanë kaluar më shumë kohë në pajisje teknologjike. "Vlera tre

trilionë përbën një tjetër moment historik për 'Apple', teksa kompania vazhdon t'ua vërtetojë të kundërtën atyre që dyshojnë", ka thënë Dan Ives, analist në kompaninë "Wedbush".

Janë dashur 16 muaj që kompanisë "Apple" t'i rritet

vlera nga 2 në 3 trilionë dollarë.

"Apple" ka qenë kompania e parë në treg që ka kapur vlerën e një trilion dollarëve në gusht të vitit 2018.

Kompania është themeluar më 1976 nga Steve Jobs dhe partnerët e tij të



biznesit, Steve Wozniak dhe Ronald Wayne

## Ambasadori i ri i ShBA-së në Kosovë: E dija se do të kthehesha

PRISHTINË, 4 JANAR - Jeff Hovenier është konfirmuar si ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë. Ditë më parë ai ka thënë ca fjalë për punën që e pret në Prishtinë. “Kosova do të jetë vendi i dhjetë në të cilin do të shërbejë”, ka thënë Hovenier, i cili në të kaluarën

ka shërbyer edhe në Turqi, Gjermani, Kroaci, Greqi, Panama, Paraguai, Peru, Serbi dhe Mal të Zi. “Gjithmonë e dija se do të kthehem”, ka theksuar ai, duke u ndërlidhur ma mandatin që do ta marrë në Kosovë. Ndër të tjera, ai ka treguar se ka angazhuar një

murator për t’i përzgjedhur pikturat të cilat do t’i vendosë në muret e shtëpisë dhe ambasadës në Kosovë. “Ne kemi investuar shumë në Ballkan. Është në interes amerikan që Kosova të jetë stabile, demokratike, prosperuese, e që do të bëhet”, ka thënë Hovenier.




# Prelec: Kurti, pa strategji në diallog

PRISHTINË, 4 JANAR - Marko Prelec, analist i lartë në Grupin Ndërkombëtar të Krizave, në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” ka thënë se qeveria e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, i ka përmbushur pjesërisht pritjet e tij.

Prelec ka thënë se nuk pret marrëveshje të rëndësishme në mes të Kosovës dhe Serbisë më 2022, edhe për shkak se Kurti dëshiron të mos i japë prioritet këtij procesi. Prelec beson se Kosova do të ishte mirë që ta provonte se çfarë mund t’i ofrojë iniciativa rajonale “Ballkani i hapur”.

Sa i përket sundimit të ligjit, ai thotë se qeveria e Kurtit duhet të ketë kujdes që luftën kundër krimit të mos e bëjë mbi baza etnike. “Jam i sigurt se nuk do të ketë përparim të madh në diallog. Ata do të takohen, mirëpo nuk do të pajtohen për asgjë të rëndësishme. Mund të pajtohen për disa çështje siç është ajo e personave të pagjetur. Evropianët mund të flasin për urgjencën e arritjes së marrëveshjes, mirëpo nuk do të thotë se diçka që është urgjente, është edhe e mundshme”, ka thënë ai.

Prelec ka thënë se çështja e asociacionit është shumë e çuditshme. “Mendoj se ka shumë dilema dhe dezinformata rreth tij. Duhet t’i kemi parasysh dy gjëra shumë të rëndësishme. E para, asociacioni nuk ka qenë diçka që dikush vërtet e ka dashur. As serbët, as kosovarët nuk e kanë dashur. Është diçka që është hartuar në Bruksel në stilin tipik të Bashkimit Evropian dhe si kompromis i paqartë që do t’ia mundësonte secilit shtet lëvizjen përpara. Kur them se serbët nuk e kanë dashur



atë, e them sepse serbët kanë dashur të mbesin brenda sistemit serb. Ata nuk kanë dashur të jenë pjesë e këtij sistemi të asociacionit. Ata kanë dashur vazhdimin e institucioneve paralele sikurse Beogradi”, ka pohuar ai.

Duke shtuar se elementi i dytë i çuditshëm i këtij asociacioni është

se 90 për qind apo më shumë e përmblajtjes ekziston në kuadër të ligjit të Kosovës. “Është thjesht një rishkrim i shumë artikujve që veçse ekzistojnë për vetëqeverisje lokale në Kosovë. Një tjetër element i rëndësishëm është se Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë vendim se Asociacioni është jokushtetues.

Ajo, në fakt, i ka kërkuar qeverisë që ta formojë Asociacionin. Sipas saj, disa dispozita ishin të paqarta, andaj mund të interpretohen kine janë kundërkushtetuese. Për arsye të ndryshme, qeveria ka vendosur ta keqinterpretojë këtë gjë duke thënë se Asociacioni është jokushtetues. Është e rëndësishme

që të zbatohet ajo për të cilën arrihet pajtueshmëri. Është çështje politike dhe nuk ka të bëjë vetëm me Lëvizjen Vetëvendosje. Kjo situatë është e përshtatshme edhe për Serbinë pasi ia jep mundësinë që të ankohet dhe ta paraqesë Kosovën si partnere të keqe”, ka thënë Prelec.

## Haradinaj pret në takim ish-ushtarakun amerikan, temë diskutimi siguria

PRISHTINË, 4 JANAR - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim ish-ushtarakun amerikan, hulumtuesin shkencor dhe njohësin e çështjeve të

sigurisë, Dan Little. Përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook”, Haradinaj ka shkruar se me Little kanë biseduar për temat e sigurisë dhe mundësitë e bashkëpunimit dhe investimeve për sigurinë

e Kosovës. “Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë aleati ynë kryesor strategjik dhe Republika e Kosovës është e vendosur për bashkëpunim bilateral në të gjitha fushat”, ka shkruar Haradinaj.





INSTITUCIONET SHËNDËTËSORE KANË NJOFTUAR PËR RITJEN E RASTEVE ME COVID

## Pas Vitit të Ri shtohen rastet me Covid

Raporti i Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKShPK) në 24 orët e fundit ka treguar për shtim të rasteve me Covid-19. Duke u bazuar në këtë raport, Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka treguar se gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar 108 raste të reja të infektimit me koronavirus. MSh-ja ka sqaruar se në kuadër të këtyre shifrave ka raste të mbledhura për tri ditë nga një laborator privat

006 testime dhe 39 raste SARS CoV-2 pozitivë të raportuara me vonesë. Kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve të raportuara sot”, është thënë në njoftimin e MSh-së. Gjithashtu, numri i qytetarëve të Kosovës që po marrin vaksinën kundër Covidit ka rënë.

Pavarësisht prej thirrjeve të institucioneve shëndetësore për t'u vaksinuar, në 24 orët e fundit vaksinën kundër Covidit e kanë marrë vetëm 2 161 qytetarë. “Në 24 orët e fundit janë dhënë 2 161 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë

dhënë 1 677 000 doza të vaksinës. Deri më sot 784 166 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Prej 6 169 testimeve, 108 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19”, është thënë në njoftimin e MSh-së.

Edhe në fillim të vitit kjo ministri u ka bërë thirrje qytetarëve që ta marrin dozën përforcuese të vaksinës. “Marrja e dozës përforcuese kundër Covid-19 do të thotë më shumë mbrojtje nga infektimi dhe përhapja e Covid-19. Për dozën përforcuese lajmërohuni në qendrën më të afërt të vaksinimit, 3 muaj pas dozës së dytë të vaksinës. Vaksinohuni dhe ftoni të tjerët të vaksinohen”, është thënë në thirrjen e MSh-së.

Shkaku i përhapjes së pandemisë nga e hëna Kosova ka ndryshuar regjimin e kalimit të tjerët për ata që dëshirojnë të hyjnë në Kosovë. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, prej 3 janarit kushdo që dëshiron të hyjë në

nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shënuar 11 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 158 078. Në total numri i rasteve aktive është 637”, është thënë në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Më pas, MSh-ja ka sqaruar se në këto rezultate janë të përfshira edhe rastet e tri ditëve të një laborator privat. “Ju informojmë se në kuadër të rasteve të raportuara sot, ka raste të akumuluarra për 3 ditë nga laborator i ‘Olive’. Gjithsej janë 1

### Gjashtë pacientë me Covid po marrin trajtim mjekësor në spitale

Në klinikat Covid-19 dhe në spitalet e përgjithshme të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës janë të shtrirë gjashtë pacientë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 29 të tjerë post-Covid. Sipas njoftimit të ShSKUK-së, me oksigjeno-terapi janë 8 pacientë. “Raporti sipas klinikave dhe spitaleve të përgjithshme: Klinika Infektive, 2 pacientë; Klinika e Pulmologjisë, 27 pacientë post-Covid; Mjekim Intensiv në Klinikë Infektive, 2 pacientë me maskë oksigjeni; Spitali i Prizrenit, 1 pacient; Spitali i Pejës, 3 pacientë”, është thënë në njoftimin e ShSKUK-së.

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 JANAR - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar për rritje të rasteve me Covid-19 në Kosovë. Në 24 orët e fundit, sipas MSh-së, 108 qytetarë kanë dalë pozitivë me koronavirus. Këto shifra kanë treguar për rritje të rasteve, ndërsa një ditë më parë janë raportuar 38 raste të reja me Covid. “Prej 6 169 testimeve, 108 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit

# Weberi: Procesi i zgjerimit do të vdesë vitin e ardhshëm nëse Gjermania s'e eliminon rezistencën e Macronit

PRISHTINË, 4 JANAR - Eksperti gjerman dhe njohësi i zhvillimeve në Ballkanin Perëndimor, Bodo Weber, në një intervistë për gazetën "Express", ka folur për rolin e Gjermanisë pa Merkelin në negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Weberi thotë se roli i Berlinit në procesin e negociatave në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të rivendoset nga qeveria e re

meqë thotë se në vitet e fundit nuk është që ka mbetur shumë nga roli drejtues i Merkelit dhe politika e BE-së për zgjerim në përgjithësi. "Në qoftë se Merkel do ta kishte marrë seriozisht rolin e saj drejtues, siç e kishte në vitin 2011-2013, ajo do ta mbyste qysh në fillimin e vitit 2018 idenë e rrezikshme për shkëmbime terriroresh dhe do të hynte në një luftë serioze me

presidentin Macron për minimin e tij serioz të procesit të zgjerimit dhe bllokimit të liberalizimit të vizave", ka thënë eksperti nga DPC-ja. Ai thotë se për gjithë këto çështje marrëveshje e koalicionit të qeverisë së re në Gjermani është premtuese meqë aty janë edhe të "Gjelbrit. "Kështu që pres më shumë nga ministrja Baerbock që të kapë atë rolin drejtues gjerman sesa

kancelari Scholz i cili ende nuk është familjarizuar me Ballkanin perëndimor", ka thënë Bodo Weberi. Ai në fund thotë se pas zgjedhjeve presidenciale në Francë, Gjermania duhet të ketë diskutime serioze me Mcronin për ta ringjallur procesin e zgjerimit, meqë presidenti francez është kundër.

Weberi thotë se pa e hequr një

rezistencë të tillë të Macronit, procesi i zgjerimit do të jetë i vdekur në vitin e ardhshëm. "Pa perspektivën e anëtarësimit në BE nuk do të ketë rol drejtues të BE-së në dialog, s'do të ketë avantazh ndaj Serbisë. Sapo të kapërcehet kjo pengesë, Berlioni dhe Uashingtoni duhet t'i bashkojnë forcat në një rivendosje të negociatave", ka përfunduar Weberi.



Kosovë duhet t'i ketë të dyja dozat e vaksinës kundër Covidit. Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, së bashku me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, këto ditë kanë mbajtur një takim virtual me kryetarët e komunave me qëllim të koordinimit ndërinstitucional për përballjen me pandeminë Covid-19.

Ministri Latifi i ka informuar

kryetarët e komunave për gjendjen e përditësuar epidemiologjike dhe për rrjedhën e procesit të vaksinimit.

Ministri Latifi dhe ministri Krasniqi i kanë falënderuar kryetarët e komunave për bashkëpunimin duke pasur parasysh se përballja me pandeminë Covid-19 kërkon përkushtimin e tyre në kapacitete maksimale.

Ministri Latifi ka theksuar se në

përputhje me rekomandimet e IKShPK-së dhe ekspertët shëndetësorë janë duke vlerësuar në vazhdimësi situatën epidemiologjike dhe ka kërkuar mbështetjen dhe angazhimin e komunave për fuqizimin e zbatimit të masave. Ai ka thënë se krahas vaksinimit, masat kundër Covidit mbeten mjetet e vetme për frenimin e pandemisë dhe evitimin e mbylljes totale.

Në Kosovë kohët e fundit janë konfirmuar nëntë raste pozitive me variantin Omicron në Kosovë. Prej 22 mostrave të testuara, nëntë prej tyre kanë rezultuar pozitive. Sipas njoftimit të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, dy raste janë të importuara nga ShBA-ja, dy nga Londra, një rast nga Franca dhe katër raste që janë detektuar në Mitrovicë mohojnë historinë e

udhëtimit dhe se kanë pasur kontakte me dikë nga jashtë.

Pas paraqitjes së variantit Omicron (B.1.1.529) në botë, Evropë, rajon e tashmë edhe në Kosovë, parashikohet që të rëndohet situata epidemiologjike. Ky variant, në bazë të të dhënave të deritanishme nga bota, ka një përhapje edhe më të shpejtë se varianti Delta Plus.

## Bëhet virale videoja e Bidenit duke dalë nga aeroplani në mes të një stuhie

UASHINGTON, 4 JANAR - Presidenti amerikan Joe Biden nuk ka mundur të zbresë për rreth 30 minuta prej aeroplanit në Uashington për shkak të një stuhie bore që goditi kryeqytetin amerikan.

Videoja, e cila tregon të parin e shtetit amerikan duke zbritur më në fund nga aeroplani, shpejt u bë virale. Biden mundi të zbriste pasi stafi i aeroportit mezi arriti t'i afronte shkallët deri te dera e aeroplanit.

Kamioni po shtynte shkallët me ndihmën e punëtorëve, ndërsa ata po çanin borën e madhe.

Më pas ai e mbuloi fytyrën me një maskë, ndërsa zbriste shkallët një agjent i shërbimit

sekret e ndoqi atë gjatë gjithë kohës.

Mbi 725 mijë qytetarë në Uashington dhe vendet përreth nuk kanë energji elektrike për shkak të stuhisë së borës.



## Heqja e kufirit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, në proces

PRISHTINË, 4 JANAR - Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë janë duke punuar që ta lehtësojnë lëvizjen e lirë për qytetarët e mallrat mes dy shteteve, por për lëvizje pa ndalesë duhet kohë, thonë zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. “Është duke u punuar që të ketë pika të veçanta të kalimit kufitar, pika të përkohshme të kalimit kufitar në mbi dhjetë fshatra të brezit kufitar. Janë duke u bërë lehtësime të tjera si bashkëpunime në ndërlidhje të sistemeve të përbashkëta të kontrollit kufitar. Po punohet për mundësinë që në raste festive, fatkeqësive natyrore apo

rrethanave të ngjashme për ta kaluar kufirin kudo jashtë pikave kufitare”, thuhet në një përgjigje me shkrim të kësaj ministrie.

Të gjitha këto masa dhe veprime, sipas ministrisë, kanë filluar të zbatohen, por për arsye teknike, financiare, të sigurisë, duhet kohë të zbatohen plotësisht, “ashtu siç është vullneti i palëve”.

Në mbledhjen e fundit të qeverive të të dyja shteteve të mbajtur në nëntor të vitit 2021, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe ai i Kosovës, Albin Kurti, kanë kërkuar nga ministrat e dikastereve përkatëse të merren me

procedurat të cilat çojnë deri në heqjen e kufirit.

Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Blendi Çuçi, dhe ai i Kosovës, Xhelal Sveçla, kanë rënë dakord që në kufi të vendosen kamera për monitorimin e automjeteve që hyjnë dhe dalin nga vendet dhe të mos kërkohen pasaportat apo letërnjoftimet nga qytetarët që kalojnë kufirin.

Nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës i kanë thënë “Radios Evropa e Lirë” se janë duke punuar në synimet që i kanë dhënë në mbledhjen e fundit të dy qeverive. “Radio Evropa e Lirë” ka kërkuar edhe nga Ministria e Punëve të

Brendshme e Shqipërisë më shumë hollësi rreth kësaj çështjeje por, deri në publikimin e këtij teksti, nuk siguroi ndonjë përgjigje.

Kufirin qytetarët e Kosovës dhe të Shqipërisë pa ndalesë kanë mundësi ta kalojnë vetëm ndonjëherë gjatë festave të apo ndonjë datë historike siç është pavarësia e Shqipërisë apo e Kosovës.

Ndër vite udhëheqësit nga Kosova dhe Shqipëria kanë dhënë deklarata të tipit ‘do ta heqim kufirin mes dy shteteve’, por kjo ende nuk ka ndodhur. Qytetarët e Kosovës dhe ata të Shqipërisë vazhdojnë t’u nënshtrohen kontrolleve në

pikat kufitare që lidhin këto dy shtete.

Në shtator të vitit 2018, Ramush Haradinaj, atëbotë kryeministër i Kosovës, pati thënë se kufiri Kosovë - Shqipëri do të hiqet në natën e ndërrimit të moteve. Pas Haradinajt, një deklaratë për heqje të kufirit në vitin 2019 pati dhënë edhe Hashim Thaçi, i cili në atë kohë ishte president i Kosovës.

Një deklaratë e tillë nuk ka munguar edhe nga Albin Kurti, kryeministër aktual i Kosovës. Por, për këto deklarata vazhdimisht kishte reaguar Qeveria e Serbisë, e cila i konsideronte rrezik për paqen.



## Sali Berisha thërret protestë më 8 janar

TIRANË, 4 JANAR - Ish-kryeministri Sali Berisha ka thirrur një protestë tjetër kombëtare më 8 janar para selisë së Partisë Demokratike. Lideri historik i Partisë Demokratike do ta udhëheqë protestën disa javë pas asaj që thirri kundër vizitës së presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, në Tiranë. “Jo bunker i pengut, por shtëpi e demokratëve”, është thënë në posterin të cilin Berisha e ka shpërndarë në profilin e vet në “Facebook”. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka reaguar pas vendimit për të thirrur një protestë

kombëtare nga ish-kryeministri Sali Berisha kundër partisë së tij. Në një postim në “Twitter”, Basha ka shkruar se është hera e parë në historinë e Shqipërisë që një politikan i lartë shpallet i padëshiruar nga ShBA-ja dhe, sipas tij, po hera e parë në Shqipëri që një politikan i tillë thërret një protestë kundër partisë së tij.

Për kreun e demokratëve protesta e thirrur nga ish-kryeministri Berisha më 8 janar ka si motiv kryesor kthimin e saj në bunker ku lideri historik i kësaj partie mund të strehohet dhe të mbrohet. “Hera e parë në

historinë e Shqipërisë që një politikan i lartë shpallet i padëshiruar nga ShBA-ja dhe po hera e parë në Shqipëri që ai thërret një protestë kundër partisë së tij, Partisë Demokratike, me motivin pse ajo nuk kthehet në bunker ku ai mund të ‘strehohet’ për t’u mbrojtur”, ka shkruar Basha.

Më 5 janar të këtij viti Berisha dhe komisioni i rithemelimit të PD-së kanë lënë afatin e fundit ndaj kryedemokratit Lulzim Basha që ta dorëzojë detyrën. Në të kundërt kanë paralajmëruar se do të sillen si “përmbarues”.

PD-ja ka akuzuar ish-



kryeministrin Berisha se po përgatit një sulm ndaj PD-së nën shoqërimin e personave të inkriminuar. Përçarja brenda partisë më të madhe opozitare shqiptare erdhi

pas largimit nga grupi parlamentar i PD-së të liderit historik Sali Berisha, me arsyetimin se ai ishte shpallur non grata nga ShBA-ja.

# Mungesa e rrymës rrezikon investimet e huaja



PRISHTINË, 4 JANAR - Kriza energjetike ka vënë në një situatë të vështirë një investitor gjerman që ka të shtrirë kapitalin në Kosovë që nga viti 2014. Është kjo kompania "Heinze" që merret me prodhimin e prodhimeve të plastikës dhe e cila ka të punësuar 20 punëtorë në Kosovë.

"Heinze" nga Kosova eksporton prodhimet e saj në vende të ndryshme të botës deri në Amerikë. Fitim Hoti, menaxher i kompanisë në Kosovë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se si pasojë e problemeve me energji elektrike, me shumë vështirësi janë i duke furnizuar me prodhime kompanitë me të cilat kanë kontrata. "Po bëhen 20 vjet dhe i njëjti problem me rrymë. Nëse ndalet dy orë jemi në rregull, por kur të vijë rryma, të jetë stabile. Me tensionin e ulët, siç po vjen, nuk mund të ndizet asnjë makinë", thotë Hoti.

Ai thotë se kanë kërkuar ndihmë nga Kompania Kosovare për Distribucion të Energjisë Elektrike (KEDS), por nuk u është bërë zgjidhje. Kjo situatë me energjinë elektrike në Kosovë duket të mos jetë fare e mirë për një investitor gjerman, i cili, siç thotë Hoti, edhe mund të largohet. "Është rrezik që mund të ikin dhe të shkojnë në

Maqedoni të Veriut, se atje është stabiliteti më i madh", thotë Hoti.

Me problemin e ngjashëm, siç është aktualisht gjendja e furnizimit me energji elektrike, kompania "Heinze" ishte përballur edhe në vitin 2020. "Me shumë vështirësi kemi arritur ta bënim një eksport te një kompani me të cilën kishim kontratë për furnizim me prodhime të plastikës", tregon ai.

Mungesa e furnizimit të rregullt me energji elektrike është një nga problemet që po e përcjell Kosovën që nga periudha e pasluftës (1999).

Në vitet e fundit gjendja ishte përmirësuar, por situata është rënduar ditët e fundit, kur kriza globale energjetike goditi edhe Kosovën.

## "Frutex"-i përgatit padinë për KEDS-in

Problemet me energji elektrike kanë goditur edhe kompaninë "Frutex" në Suharekë. Shaqir Palushi, pronar i kompanisë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se i janë shkaktuar mijëra euro dëme në makineri për shkak të rrymës. "Ne për katër ditë pothuajse për asnjë moment nuk kemi pasur energji

elektrike. Edhe kur ka pasur energji elektrike, ka qenë e tensionit të ulët dhe ne është dashur ta vazhdojmë punën me gjeneratorë. Kjo shkakton probleme në linjat e prodhimit", thotë Palushi.

Për dëmet që i janë krijuar kompanisë, Shaqir Palushi është në përgatitje e sipër të një padie për KEDS. "Ne jemi parapagues të rregullt të rrymës dhe një furnitor kur nuk e përmbush kontratën duhet të përballet edhe me padi, pasi që edhe ne kemi obligime ndaj blerësve tanë", thotë ai.

KEDS/KESCO në bazë të licencës dhe kontratave me konsumatorët ka për obligim furnizimin e pandërprerë me energji elektrike pavarësisht sa janë kapacitetet prodhuese të Korporatës Energjetike të Kosovës.

## Zeka: Energjia jostabile po dekurajon investitorët

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se furnizimi stabil me energji elektrike është një nga faktorët më të rëndësishëm në funksionimin e bizneseve. Mungesa e këtij produkti, shton

Zeka, po dekurajon investitorët ndërkombëtarë të vijnë në Kosovë. "Kriza aktuale energjetike dhe mosveprimi i institucioneve të vendit për ta evituar krizën aktuale që së paku e njëjta të mos përkthehet në vështirësi të operimit të bizneseve, qofshin ata investitorë të jashtëm apo të brendshëm, dekurajojnë investitorët që kanë vendosur të investojnë apo edhe ata të tjerët që kanë konsideruar që ta zgjerojnë aktivitetin e tyre në Kosovë", thotë Zeka.

Lajmet në medie ndërkombëtare se Kosova është në krizë të thellë energjetike dhe ka mungesë të furnizimit, shton Zeka, e rëndojnë imazhin para investitorëve të huaj. Problemi me furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike në Kosovë ishte theksuar edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për Klimën e Investimeve të publikuar në vitin 2020. Në këtë raport thuhej se Kosova ka potencial për të tërhequr investime të huaja direkte, por një nga problemet që e pengon ardhjen e investitorëve të huaj në Kosovë është edhe furnizimi jo i besueshëm i energjisë.

Që nga 22 dhjetori konsumatorët në Kosovë po përballet me reduktime të

energjisë elektrike. Situata energjetike është përkeqësuar pasi konsumi i energjisë nuk po mund të mbulohet nga kapacitetet prodhuese të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Aktualisht prodhohen deri në 600 megavatë rrymë në orë, kurse konsumi ka arritur deri në 1 400 megavatë në orë. Kriza globale energjetike ka nisur tash e sa muaj, kryesisht për shkak të mungesave të gazit dhe rritjes së çmimeve të gazit.

## Pak investime ndërkombëtare

Sipas të dhënave të Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), dërguar "Radios Evropa e Lirë", përgjatë periudhës janar - shtator 2021, shuma zyrtare e investimeve të huaja është 321.8 milionë euro. Nëse krahasohen me vendet e rajonit, si Shqipëria dhe Serbia në Kosovë, investimet e huaja janë shumë më të ulëta. Sipas raportit të Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim, në Serbi, në formë të investimeve të huaja, gjatë vitit 2020 kanë hyrë 3.4 miliardë dollarë, derisa në Shqipëri janë investuar 1.1 miliardë dollarë.

## Bien çmimet e naftës përpara takimit të vendeve të OPEC-ut

PRISHTINË, 4 JANAR - Çmimet e naftës kanë rënë gjatë martës, ndërkohë që investitorët presin që prodhuesit kryesorë në botë t'i mbajnë premtimet e rritjes së prodhimit gjatë takimit të vendeve të Organizatave të Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC). Nafta Brent ra 25 cent në 78.74

dollarë për fuçi, ndërsa nafta bruto amerikane (WTI) ra me 19 cent në 75.89 dollarë për fuçi. Analistët thonë se faktori kryesor që po ndikon te çmimet botërore të naftës për momentin është manaxhimi i ofertës nga vendet e OPEC+. Sipas ekspertëve, shqetësimet

mbi kërkesën për karburant nga përhapja e variantit Omicron po tërhiqen dhe nxjerrja në treg e planifikuar nga rezervat strategjike të naftës është më e vogël sesa pritej. Burimet bëjnë me dije se karteli pritet t'i mbajë premtimet e rritjes së prodhimit me 400

mijë fuçi në ditë në muajin shkurt, si çka bërë çdo muaj që prej gushtit 2021. Në fund analistët paralajmërojnë se OPEC+ mund të ndryshojë kurs nëse rriten tensionet mes perëndimit dhe Rusisë mbi Ukrainën, apo nëse bisedimet mbi programin bërthamor të



Iranit bëjnë progres, çka pritet t'i heqë sanksionet e naftës ndaj vendit.

## KOSTT-i, kompani lidere në sektorin publik për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë

PRISHTINË, 4 JANAR - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) është certifikuar me Standardin Ndërkombëtar ISO 27001:2013, gjegjësisht Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit (ISMS). Përmes këtij certifikimi globalisht të njohur, KOSTT-i tregon angazhim serioz për zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në sigurinë e informacionit, mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërinë e informacionit konform

standardit ISO/IEC 27001:2013. Me rastin e pranimit të certifikatës, Jusuf Imeri, menaxher i Politikave dhe Cilësisë në KOSTT, ka theksuar: "Ne tashmë kemi ndërtuar një sistem të integruar të cilësisë në bazë të së cilës janë të mbështetura proceset. Kjo përbën një vlerë të shtuar për kompaninë duke siguruar kështu ofrimin e shërbimit cilësor në përputhje me standarde të përcaktuara ndërkombëtare të cilat na ndihmojnë në zbatimin efikas të kërkesave ligjore, rregullatore dhe palëve të interesit", ka thënë



Imeri. Standardi për informacionit ISO 27001:2013 është standardi i katërt menaxhimin e sigurisë së

ndërkombëtar me të cilin tashmë u certifikua KOSTT-i krahas standardit për menaxhimin e Cilësisë ISO 9001:2015, Standardin e Sigurisë dhe Shëndetit në punë ISO 45001:2018 dhe Standardin e Mbrojtjes së Mjedisit ISO 14001:2015. Me këtë KOSTT bëhet kompania e parë publike dhe kompania e parë në sektorin e energjisë në Kosovë e certifikuar me Standardin Ndërkombëtar ISO/IEC 27001:2013, duke e përmbyllur kështu vitin 2021 me një sukses që dëshmon vazhdimësi të ekselencës së biznesit.

## Kriza energjetike ndalon prodhimin e kriptovalutave në Kosovë

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 JANAR - Kriza me energji elektrike në Kosovë ka bërë që qeveria ta ndalojë prodhimin e kriptovalutave në vend. E gjithë kjo ka ardhur pas rekomandimeve të Komitetit Teknik për Masat e Emergjencës për Furnizimin e Energjisë i cili u formua së fundmi nga vetë Ministria e



Ekonomisë. Ministrja Artane Rizvanolli ka bërë me dije të martën se institucionet e rendit do ta

ndalojnë prodhimin e tyre. "Në fund të vitit të kaluar me vendim të Qeverisë së Kosovës kemi themeluar Komitetin Teknik për 'Masat e emergjencës në furnizimin e energjisë'. Ky Komitet Teknik ka mbajtur dy takime për të identifikuar dhe rekomanduar zbatimin e masave për t'i trajtuar efektet negative të rrethanave të krijuara nga kriza energjetike botërore.

Duke u bazuar në rekomandimet e këtij Komiteti Teknik javën e kaluar kam marrë vendimin për Masa të Emergjencës përmes të cilit ndalohet prodhimi i kriptovalutave në të gjithë territorin e Kosovës. Institucionet e rendit do ta ndalojnë prodhimin e aktivitetit në fjalë me mbështetje të të gjitha institucioneve relevante, të

cilat do të identifikojnë lokacionet e prodhimit të kriptovalutave. Këto obligime kanë për qëllim trajtimin e çfarëdo mungese të papritur ose afatgjatë të kapacitetit prodhues energjetik, kapacitetit të transmetimit apo të shpërndarjes së energjisë në mënyrë që ta tejkalojmë krizën e energjisë pa rënduar më tej qytetarët e Kosovës", ka njoftuar ministrja Rizvanolli.

## BKS-ja pagoi mbi 10 milionë euro dëme të shkaktuara nga automjetet në vitin 2021

PRISHTINË, 4 JANAR - Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) ka arritur të paguajë një shumë rekorde të dëmeve të shkaktuara nga automjetet me targa të huaja si dhe automjetet e pasiguruara në vitin 2021. Gjithashtu, pavarësisht prej sfidave në të cilat

ka kaluar vitin që lamë pas BKS-ja si pasojë e pandemisë Covid-19, viti 2021 është mbyllur me performancë të mirë si për trajtim të dëmeve në shihtë të policave kufitare, po ashtu edhe implementim të rekomandimeve të dhëna në fillim të vitit nga

Banka Qendrore e Kosovës. "Pagesa e dëmeve ka qenë prioritet imi që nga ardhja në krye të BKS-së, ku në këtë drejtim ne kemi arritur të trajtojmë një numër rekord të dëmeve si në numër, ashtu edhe në vlerë. Ritëm i njëjtë do të vazhdojë edhe gjatë

vitit 2022", ka thënë drejtori i BKS-së, Sami Mazreku. Ai për sukseset e arritura ka falënderuar edhe Bankën Qendrore të Kosovës si dhe drejtorët e kompanive të cilët në vazhdimësi kanë treguar gatishmëri për të derdhur mjete në Fondin e Kompensimit.



## Kosova lanson 'e-Testimi' për patentëshofer, zbatimi nga janari 2022

Prishtinë, 29 dhjetor (ER) - Nga 5 janari i vitit 2022 në shtatë qendrat e patentëshoferëve në gjithë Kosovën do të zbatohet "e-Testimi". Kandidatët për patentëshofer

do të testohen në mënyrë elektronike dhe menjëherë pas përfundimit të testimit do të kenë mundësi ta kuptojnë rezultatit e testit. Zëvendësministri i Infrastrukturasë, Hysen

Durmishi, ka thënë se përmes këtij projekti do të lehtësohet puna e njëjësive të patentëshoferëve, duke shtuar se do të eliminohet edhe mundësia që përmes aferave korruptive të pajisjen

qytetarët me patentëshofer. Projekti për "e-Testim" për patentëshofer ka nisur si pilot në vitin 2016 dhe deri më tani ka qenë i praktikuar vetëm në njërin njësi në qendrën për patentëshofer në Prishtinë.





# Dhjetë zbulimet arkeologjike më magjepsëse të vitit 2021



Pavarësisht të gjitha problemeve që lidhen me pandeminë e Covid-19 që po vazhdon ende, studiuesit arritën zbulime arkeologjike mbresëlënëse edhe gjatë vitit 2021. Ja cilat janë 10 më të rëndësishmet:

## Gjeoglifi i madh në Indi

Gjeoglifi ndoshta më i madh në botë, u zbulua në shkretëtirën Thar në Indi afër kufirit me Pakistanin. Me një sipërfaqe prej rreth 20.8 hektarësh, gjeoglifi përbëhet nga disa spirale gjarpëruese që shkojnë sa para mbrapa.

Gjatësia totale e vijave të tij është 48 km. Gjeoglifi mendohet se është ndërtuar rreth 150 vjet më parë, por synimi i tij mbetet i paqartë. Ai u zbulua fillimisht nga një ekip studiuesish, që po analizonin peizazhin duke përdorur Google Earth.

## Qyteti i Artë i humbur

Arkeologët e zbuluan qytetin pranë Luksorit (Tebës së lashtë) në Egjipt. Qyteti njihet si "Ngritja e Aten" dhe u themelua nga faraoni Amenhotep III, që sundoi midis viteve 1391-1353 Para Erës Sonë. Qyteti përmban shumë shtëpi, godina administrative, një furrë të

madhe buke, një zonë prodhimi për tulla prej balte dhe disa varreza. Dokumentet historike sugjerojnë se Amenhotep III kishte 3 pallate mbretërore në qytet, ndërsa gërmimet

arkeologjike në këtë sit janë duke vazhduar.

## Zbulimi i skeletit të një njeriu të kryqëzuar në epokën e Romës së lashtë

Në Kembrixhshajër të Britanisë së Madhe, arkeologët zbuluan trupin e një burri që ishte kryqëzuar në moshën 25-35 vjeç. Një gozhdë u gjet e ngulur në të paktën njërin prej kockave të thembrës së tij. Arkeologët zbuluan se kockat e këmbës së tij ishin të holla, dhe kjo do të thotë se ai ka të ngjarë të ketë qenë i lidhur në një mur për një kohë të gjatë përpara kryqëzimit. Varrimi daton në shekullin III ose IV dhe viktimë mund të ketë qenë një skllav.

## Harta më e vjetër e Evropës

Një seri gdhendjesh mbi një pllakë guri 4000-vjeçare të zbuluara në Francë, përfaqësojnë hartën më të vjetër të Evropës deri më sot. Pllaka bart një seri vijash që përfaqësojnë lumin Ode dhe luginën e tij përreth në Francën Perëndimore, një zonë me përmasa 30 kilometra e gjatë dhe 21 km e gjerë.

Në fakt pllaka e gurit ishte gjetur që në vitin 1900. Por vetëm këtë vit, fotogrametria ndërtoi një imazh 3D shumë të detajuar të pllakës, duke zbuluar se gdhendjet përbëjnë një hartë. Ajo

mund të jetë përdorur nga një princ ose mbret për të ilustruar territorin mbi të cilin sondonte.

## Përqaftimi i të dashuruarve të lashtë

Rreth 1500 vjet më parë, një çift u varrosën së bashku të përqaftuar. Kur arkeologët gjetën mbetjet e tyre, përqaftimi i tyre ishte ende i paprekur pavarësisht kalimit të kohës. "Ky është çifti i parë që gjendet në këtë pozicion në Kinë" - tha drejtuesit i gërmimeve Qian Uang, profesor i asociuar në Departamentin e Shkencave Biomjekësore në Kolegjin e Stomatologjisë A&M në Teksas. Burri ishte i moshës 29-35 vjeç dhe kishte disa lëndime, përfshirë një krah të thyer dhe humbjen e gishtit në dorën e djathtë. Gruaja ishte midis 35-40 vjeç dhe kishte disa kavitate, por pa lëndime të dukshme. Studiuesit spekulojnë se pasi vdiq burri, gruaja mund të ketë vrarë veten për t'u varrosur bashkë me të.

## Varreza më e vjetër në botë e kafshëve shtëpiake

Një varrezë 2000-vjeçare e kafshëve shtëpiake, që mund të jetë shembulli më i vjetër i njohur në botë, u zbulua në Berenice, një qytet-port në bregun e Detit të Kuq në Egjipt. Kafshët e varrosura në këtë varrezë, duket se kanë ngordhur nga shkaqe natyrore, dhe ishin mbajtur me

shumë kujdes nga pronarët e tyre. Në vendvarrime të tjera në Egjipt, kafshët shpesh flijoheshin për nder të perëndive.

## Parada 11.000-vjeçare

Një vend prehistorik 11.000-vjeçar në Turqi, që sot quhet Karahantepe, u përdor dikur për një paradë parahistorike kur njerëzit parakolonin nëpër një ndërtesë me shtylla në formë fallusi, dhe në majë me gdhendjen e një kokës së një njeriu.

Kjo ndërtesë është pjesë e një kompleksi më të madh. Gërmimet në këtë sit kanë filluar në vitin 2019. Ai daton në një kohë të ngjashme me Gobekli Tepe, një sit tjetër arkeologjik me ndërtesa të mëdha dhe gdhendje kafshësh dhe kokash njerëzish.

## Monumenti më i vjetër i luftës

Një varrezë 4300-vjeçare në Siri, në sitin Tell Banat, mund të jetë monumenti më i vjetër i luftës i njohur në botë. Arkeologët thonë se ai përmban kufomat e të paktën 30 luftëtarëve së bashku me armët tyre. Mbishkrimet e lashta në Mesopotami, tregojnë se si trupat e të vdekurve të luftës grumbulloheshin në një strukturë shumë të organizuar. Zbulimi tregon "se njerëzit e lashtë i nderonin të rënë në betejë, ashtu si ne sot" - thotë Ana Porter, profesoreshë e Qytetërimeve të lashta të Lindjes


së Mesme në Universitetin e Torontos.

## Njeriu Dragua

Shkencëtarët në Kinë kanë raportuar zbulimin e një speciejë të re njerëzore, të cilën e quajnë Homo longi që do të thotë "Njeriu Dragua". Kjo u mësua nga një kafkë që u gjet në vitin 1933, por që ishte fshehur në një pus gjatë pushtimit japonez të Kinës, dhe ku mbeti atje për 85 vjet derisa u ri-zbulua dhe u studiuua. Studimet sugjerojnë se "Njeriu Dragua" mund të jetë specia e lidhur më e afërt me Homo Sapiens. Nuk është e qartë se kur është shfaqur saktësisht "Njeriu Dragua" dhe kur është zhdukur ai, por vetë kafka daton diku midis 309.000 dhe 138.000 vjetëve më parë.

## Vizatimi më i vjetër i një fantazme

Një kurator në një muzeum identifikoi një gdhendje mbi një pllakë babilonase 3500-vjeçare, atë që konsiderohet si përshkrimi më i vjetër i njohur i një fantazme. Fantazma është një burrë me mjekër. Ai paraqitet i vrenjtur teksa çon një grua të lidhur me një litër në botën e përtejshme. Pllaka ndodhet në Muzeun Britanik, pasi është blerë që në shekullin XIX-të, por fantazma nuk ishte vënë re deri vonë. / bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Ademi: Trajneri i ri emërohet në mars, duhet t'i plotësojë këto kushte

PRISHTINË, 4 JANAR - Nga përfaqësuesja tek implemmentimi i VAR-it dhe projektet e ardhshme. Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, analizon futbollin e Kosovës gjatë vitit 2021 në një intervistë për "KosovaPress" që, pavarësisht prej vështirësive që solli pandemia, ai mendon se ka pasur rezultate të dukshme. Përfaqësuesja e Kosovës pati një vit me rezultate zhgënjyese çka çoi edhe në ndërprerjen e bashkëpunimit në mes të FFK-së dhe trajnerit zviceran Bernard Challandes. Ademi mendon se ish-trajneri i ka dhënë shumë Kosovës, ndërsa nuk pati fat me dëmtimet e lojtarëve. "Nga lëndimi i Arbër Zenelit asnjëherë nuk kemi mundur të jemi kompaktë dhe komplet ekipi i cili ka qenë i përcaktuar të jetë në 11-shën e parë. Arbër Zeneli është parë që vlen shumë në ekipin tonë. Pastaj ndryshimi i futbollistëve kryesorë, ndërrimi i ekipeve duke bërë kontrata të tjera që kanë shkuar në ekipe të tjera dhe ndërrimi i sistemit të lojës ka bërë që këta futbollistë të mos jenë në gjendje të mirë. Unë e falënderoj Challandesin për punën që e ka bërë sepse një trajner i cili bëhet kampion për herën e parë në Ligën e Kombeve për ne nuk ka qenë rezultat edhe i vogël, pastaj 14 ndeshje pa asnjë humbje nuk është lehtë të bëhen. E kam konsideruar një punë që e ka bërë të zellshme, prandaj e kam duruar deri në momentin e fundit, deri kur erdhi momenti që thjesht u desh me u nda me Challandesin për faktin se menduam që nuk kishte çfarë të jepte më shumë në këtë ekip", ka

deklaruar Ademi, i cili ka konfirmuar se ndarja me Challandesin ishte miqësore. "Ndarja ka qenë miqësore dhe e ka pasur të qartë edhe Challandesin sepse është njeri me përvojë dhe e ka parë që unë e kam tejkualuar edhe pjesën e pritshmërisë deri në fund dhe ai, përveç kësaj, ma ka njohur si të drejtë dhe një falënderim e kam pasur që ju keni pritur deri në momentin e fundit sepse ndoshta me dëshirë ose me format të futbollit është dashur pak më herët të ndahemi me atë, por e kemi pritur edhe disa ndeshje dhe në fund erdhi çasti që me Challandesin ndarja ka pasur të ndodhë, pavarësisht a do t'i kishte fituar edhe këto ndeshje apo do t'i kishte humbur, ndarja ka pasur të ndodhte gjithsesi sepse ne po kërkojmë diçka tjetër tani e tutje, diçka më shumë sepse mendoj që me këtë gjeneratë që e kemi ne mund ta kualifikojmë Kosovën dhe duhet ta kualifikojmë. Me çdo trajner që bëj kontratë sigurisht që kërkojmë rezultate sepse Kosova e ka kohën e rezultateve, e ka kohën e kualifikimeve", u shpreh Ademi. Trajneri i ri nuk është përzgjedhur ende dhe kjo, sipas Ademit, nuk do të bëhet deri në muajin mars. "Fillimisht duhet të jetë një trajner punëtor, e dyta që e njeh mentalitetin tonë dhe i njeh shumicën e lojtarëve, pastaj është edhe çështja ekonomike si kriter dhe natyrisht që marrëveshjet me ta do t'i bëjmë në formatin e ri që bëhen. Rezultate gjithsesi kërkojmë sepse nuk ka me çdo kusht asnjë trajner. Nuk besoj që mund të jetë një botë që mund ta garantojë kualifikimin



sepse në futboll nuk ka asgjë të qindpërqindtë, por duhet punuar për të shkuar deri atje, por të paktën objektivat tona janë për kualifikim dhe duhet ta bëjë punën për të qenë një ekip kualifikues e jo një ekip vetëm sa për të qëndruar në këtë grup", ka shtuar Ademi. Elementet e kërkuara nga drejtuesit e federatës nuk do të thotë se nuk mund të gjenden edhe te një trajner vendor dhe se Ademi thotë se ka ëndërr që një ditë ta emërojë një trajner kosovar në krye të ekipit kombëtar. Duke iu rikthyer futbollit kosovar, 2021-shin Ademi e cilëson vit të vështirë, por jo pa rezultate. "Fillimisht një vit i vështirë për shkak të pandemisë, por jam shumë i lumtur që ka përfunduar gjithçka në rregull dhe madje mund të them që s'vijet e kemi ngritur edhe nivelin e garave, por edhe të organizimit edhe të financimit të investimeve dhe të gjitha. Përkundër krejt kësaj, shfrytëzoj rastin ta falënderoj UEFA-n dhe FIFA-n të cilët na kanë ndihmuar, sidomos UEFA-n nga 'hat-trick' i cili është komision që bën investime në projekte të cilat i kanë federatat, po ashtu edhe

sponsorët tanë. Kemi arritur që ta mbajmë gjallë futbollin ose ta mbajmë në nivelin e duhur duke pasur parasysh që barrën më të madhe e kanë pasur sponsorët e klubeve ose investitorët e klubeve. Ndoshta diku ka pasur disa çalime, por gjithsesi e përgjithshme është shumë e mirë për vetë faktin se garat janë zhvilluar dhe po zhvillohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Pra mund të them që është një vit, përkundër pandemisë, një vit i suksesshëm i futbollit të Kosovës në të gjitha kategoritë", ka deklaruar Ademi. Implementimi i teknologjisë VAR në Superligën e Kosovës ishte padyshim një nga arritjet më të mëdha të vitit 2021 dhe se për këtë projekt, i pari i FFK-së ndihet krenar. Ai thotë se shumë shpejt mund të shohim një ekip të VAR-it të Kosovës në gara ndërkombëtare. "E kemi bërë më së shpejti dhe është si shembull në UEFA dhe në FIFA që për herë të parë është bërë një VAR kaq shpejt dhe madje i suksesshëm dhe me shumë sukses, do të thotë që është bërë me të gjitha konditat dhe të gjitha normat që bëhet një VAR në botë. Jo vetëm që jemi të parët, por jemi prej pak shteteve që e kemi bërë për kaq kohë. Nuk është se krejt shtetet e botës ose krejt federatat e kanë VAR-in edhe pse kushtueshmëria e tij ka qenë jashtëzakonisht e madhe për federatën tonë, por gjithsesi i falënderoj shumë që rimbursimin dhe pagesa e të gjitha shpenzimeve që janë bërë dhe kushtueshmëria e këtij VAR-i e ka bërë FIFA me shumë e plotë që rrallëherë ia bën ndonjë

federate. Edhe është treguar i rezultatshtëm sigurisht dhe po tregohet i rezultatshtëm dhe përveç që e kanë marrë me seriozitet, mund të them që shumica prej tyre e kanë perfeksionuar punën e tyre dhe shumë lehtë mund ta shohim në Kampionatin Botëror që tani në Katar një ekip i VAR-it të Kosovës që do të jetë në garat ndërkombëtare, siç vijmë ekipet e tjera në Kosovë", ka deklaruar i pari i FFK-së.

Por, VAR-i nuk do të jetë lëvizja e fundit sa i përket digjitalizimit të futbollit kosovar. Ademi zbulon se do të vazhdohet edhe më tutje në këtë drejtim aq sa edhe këpucët e lojtarëve dhe topat në stërvitje të digjitalizohen për të krijuar një databazë për efektivitetin e punës së lojtarëve. "Ne i kemi bërë katapultat, i kemi dërguar nëpër klube, e kanë mundësinë ta shohin veten futbollistët se sa e kanë kapacitetin. Pas këtyre do të vijmë katapultat në këpucë të lojës me të cilat do ta shohim precizitetin ose preklshmerinë se sa herë e kontakton topin një futbollist. Pas kësaj, faza e fundit është edhe topat, sigurisht që do të jenë në stërvitje për të parë precizitetin dhe shpejtësinë e goditjes të secilit futbollist", ka thënë Ademi, i cili bëri me dije se Federata e Futbollit të Kosovës i ka përfunduar të gjitha projektet e planifikuara gjatë vitit 2021, derisa ka shtuar se në këtë rrugë do të vazhdohet edhe në vitin 2022 ku do të realizohen shumë investime në infrastrukture, duke përmendur edhe ndërtimin e një kampi tjetër stërvitor për të rinjtë si dhe një punë të madhe për ritjen e cilësisë të kampionatit vendor.

## FC Phoenix - Banjë përforcohet me gjashtë futbollistë



PEJE, 4 JANAR - Klubi i futbollit, Phoenix, ka zyrtarizuar gjashtë futbollistë të rinj në afatin kalimtar të dimrit. Skuadrës nga Banja e Pejës i janë bashkuar Zeki Ademi, Dardan Rogova, Rron Rogova, Adnan Haxhaj, Ardit Vokshi dhe Musa Kambi. Lajmi është bërë me dije nga faqja zyrtare e klubit e cila njëherësh edhe i ka paraqitur lojtarët e rinj në ambientet e klubit.

Me këto transferime klubi i Phoenixit synon Superligën e Kosovës në futboll nga Liga e Parë. Ardhjet e reja konsiderohen nga klubi se do ta stabilizojnë edhe më shumë skuadrën për stinorin pranveror. Në postimin zyrtar në "Facebook" ky klub bën me dije se synon të luftojë për inkuadrin në Superligë. "FC Phoenix - Banjë synon Superligën dhe e arsyeton

synimin me gjashtë përforcime serioze për stinorin pranveror. Me fillim të vitit 2022 FC Phoenix - Banjë siguron superpërforcime. Ardhjet e reja e stabilizojnë edhe më shumë skuadrën dhe e qartësojnë edhe më shumë rrugën drejt Superligës. Lojtarët që i bashkohen FC Phoenix - Banjë janë: Zeki Ademi nga Trepça '89, Dardan Rogova, Rron Rogova,

Adnan Haxhaj, Ardit Vokshi nga Vllaznimi si dhe Musa Kambi ish-lojtar i Eintracht Frankfurtit", thuhet në njoftimin e klubit. Kjo skuadër ditë më parë nga KF Onix e ndryshoi emrin në FC Phoenix - Banjë derisa në sezonin vjeshtor garat i mbylli në vendin e tretë të Grupit A të Ligës së Parë me 21 pikë, një pikë më pak se vendi i dytë dhe pesë pikë më pak se vendi i parë.

## Top asistuesit e Superligës

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Organizatorët janë truri i skuadrës dhe asgjë nuk do të funksiononte pa asistimet e tyre. Lojtari që bën më shumë dhurata apo asistime për bashkëlojtarët e tij është Ivan Koljeviq i Prizrenit 16 me

8.3 asistime për ndeshje, apo më të lartën në elitën e basketbollit të Kosovës. Në vendin e dytë ndodhet organizatori turk i Pejës, Ilter Erdem, me 7.3, ndërsa Altin Morina ka 6.7 asistime për ndeshje. Organizatori i

Trepçës, Amin Hoti, është në vendin e katërt me gjashtë asistime për ndeshje, ndërsa top pesëshen e përmbyll Jan Palokaj i Sigal Prishtinës me 5.9 asistime për ndeshje, një sukses për të, pasi nuk luan në pozitën e organizatorit,

megjithatë ndihmon e shumë skuadrën. Top pesë asistuesit: Ivan Koljeviq (Prizreni 16) 8.3, Ilter Erdem (Peja) 7.3, Altin Morina (Rahoveci) 6.7, Amin Hot (Trepça) 6.0, Jan Palokaj (Sigal Prishtina) 5.9.



## 'El Clasico' për Haalandin

MADRID, 4 JANAR - Erling Haaland është një nga lojtarët që po përflitet shumë në këtë merkato. Zëra të shumtë e lidhin sulmuesin e Dortmundit me skuadrën e Real Madrid dhe, siç duket, e ardhmja e 24-vjeçarit qenka e lidhur

ngushtë me kampionatin spanjoll. Një nga golashënuesit më të mirë të futbollit evropian ka vënë në garë dy skuadra gjigante të La Ligës. Një "El Clasico" në mes të Real Madridit dhe Barcelonës do të shikojmë në këtë

merkato dhe "lufta" mes dy ekipeve për transferimin e sulmuesit norvegjez do të jetë e ashpër. Sipas "Marca", Barcelona ka nisur bisedimet me agjentin e lojtarit, Mino Raiola, për të transferuar Haaland në "Camp

Nou". Në këtë duel më i avantazhuar duket "Los Blankos" për shkak edhe të situatës ekonomike që ka për momentin, por gjithsesi Joan Laporta ka premtuar një goditje "big" për sulmin e skuadrës së Xavi



Hernandezit dhe Haaland mund të jetë lojtari "Big" i premtuar.

## Ancelotti: Italia e sigurt me Mançinin, ja kush e fiton Serinë A

MADRID, 4 JANAR - Real Madridi e filloi vitin 2022 me humbjen 1-0 në fushën e Getafes, duke u dhënë fund 11 rezultateve pozitive radhazi në La Liga, aty ku kryeson me 5 pikë më shumë se Sevilla (ka luajtur një ndeshje më pak). Trajneri i ekipit madrilen, Carlo Ancelotti, ka prekur disa tema të ndryshme në intervistën e dhënë për "Il Messaggero", aty ku shprehet i bindur se Italia do të kualifikohet në Botërorin e Katarit. Kampionët në fuqi të Evropës duhet të fitojnë në muajin mars kundër Maqedoninë së Veriut dhe më pas ndaj fituesit të çiftit Portugali - Turqi për të siguruar një biletë për në Katar. "Humbja ndaj Getafës erdhi për disa shkaqe, si Covidi dhe dëmtimet, por skuadra ime është solide, e kemi treguar edhe më parë në dhjetë fitoret radhazi. Le të themi se ishim ende me pushime", ka thënë Ancelotti, i cili pati një koment edhe për Serinë A. "Shoh Interin



si ekipin favorit për fitimin e titullit. Simone Inzaghi ia ka dalë të mos ndihen largimet e Lukakut dhe Hakimit", ka shtuar ai. Trajneri Carlo Ancelotti e lavdëroi edhe trajnerin e Italisë, Roberto Mançini, duke thënë se Italia është e sigurt me

Mançinin në krye. "Mançini do të na kualifikojë në Katar 2022. Të mbetemi dy herë radhazi jashtë një Botërori do të ishte një goditje e madhe për Italinë, sidomos pas suksesit të madh në 'Euro 2020', ka deklaruar Mançini.

## Golden State nuk ndalet, humb Milwaukee dhe Brooklyn

SAN FRANCISCO, 4 JANAR - Skuadra e Golden States ruan kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit në NBA pas fitores 115-108 ndaj Miami. Poole me 32 pikë ishte më i miri për vendasit, mbështetur edhe nga Wiggins me 22 pikë. Zhgënjën skuadra e Brooklynit, që në fushën e saj u mund 118-104 nga Memphis. Moranti realizoi 36



pikë dhe Bane 29, një dyshe që bëri dallimin në fushë për miqtë, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Durantit për vendasit. Edhe skuadra kampione e Milwaukee ka dalë e humbur sot, pasi u

mposht 115-106 nga Detroiti. Bey realizoi 34 pikë për miqtë, mbështetur edhe nga Jacksoni me 24 pikë, ndërsa për Bucksin u dallua Giannisi me 31 pikë e 10 rebounde, por që mbetën për statistikë.

### REZULTATET

Philadelphia - Houston	133-113
Washington - Charlotte	124-121
Brooklyn - Memphis	104-118
Chicago - Orlando	102-98
Milwaukee - Detroit	106-115
New Orleans - Utah Jazz	104-115
Dallas - Denver	103-89
Golden State - Miami	115-108
Portland - Atlanta	136-131
Clippers - Minnesota	104-122

### SHKURT

#### Cagliari interesohet për Bajramin

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Nedim Bajrami, është duke kaluar nëpër një formë fantastike në Serinë A. Skuadra e Cagliarit është në kërkim të përforcimeve në afatin kalimtar të janarit teksa objektivi kryesor ka mesfushorin shqiptar. Megjithatë, Empoli për ta lënë të lirë Bajramin është duke kërkuar 11 milionë euro, shkruan "Tuttomercatoweb". Bajrami me Empolin në këtë sezon ka zhvilluar 22 paraqitje, teksa ka shënuar gjashtë gola dhe ka asistuar katër të tjerë.

#### Buffoni rezulton pozitiv me Covid

Portieri Gianluigi Buffon është infektuar me Covid-19. Lajmin e ka bërë me dije skuadra e Parmës, kurse Buffoni është i vetmi që ka rezultuar pozitiv. Buffoni ka bërë 18 paraqitje në Serinë B për Parma deri më tani këtë sezon, duke e mbajtur gjashtë ndeshje portën e paprekur dhe duke pritur tri penalti.

#### Mbappe arrin shifrën e 200 golave

Kylian Mbappe ka arritur në shifrën e 200 golave në karrierë. Sulmuesi francez e ka bërë këtë gjë teksa ende është vetëm 23-vjeçar. Në ndeshjen ndaj Vennes në kuadër të Kupës së Francës, Mbappe realizoi tre gola për të shkuar në shifrën e 201 golave gjithsej. Ai i ka realizuar 150 gola me Paris Saint-Germainin, 27 me Monaco dhe 24 me ekipin kombëtar të Francës. Këtë shifër Mbappe e arriti në 309 ndeshje sa i ka zhvilluar gjithsej. Mbappe erdhi në Paris Saint-Germainin në vitin 2018, duke treguar performanca të jashtëzakonshme, ndërsa në verë pritet të transferohet në Real Madrid.

#### Malcuit infektohet me Covid

Mbrojtësi i skuadrës së Napolit, Kevin Malcuit, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Këtë lajm e ka publikuar vetë klubi napolitan me anë të kanaleve zyrtare teksa sqaron se edhe Andrea Patenga ka përfunduar periudhën e vetizolimit dhe ka dalë negativ nga virusi SARS-COV-2. Në komunikatën e klubit të kaltër thuhet se të dy lojtarët kanë qenë totalisht të vaksinuar me të dyja dozat dhe Malkui është totalisht asimptomatik dhe do t'i ndjekë me përpikëri rregullat e protokollit anti-Covid duke u vetëkarantinuar në banesën e tij.

#### Osaka rikthehet me fitore pas 4 muajsh, Tsitsipas në dyshim për Australian Open

Më 17 janar do të nisë në Melburn grand slam i Australian Openit dhe tenistët janë duke bërë përgatitjet e fundit. Pothuajse të gjithë tenistët ndodhen në Australi, ku po marrin pjesë në disa turne të vegjël. Në fushë është rikthyer pas katër muajsh pushim ish-numri një në botë, tenistja japoneze Naomi Osaka. Ajo është kampione në fuqi e Australian Open, por muajt e fundit kaloi një krizë psikologjike dhe nuk luajti. Në turneun e Melburn Summer Set, ajo fitoi 2-1 (6-4, 3-6, 6-3) ndaj francezes Aлизе Cornet. Kjo është fitorja e parë e Osakës pas 4 muajsh dhe duket se do të luftojë deri në fund për ta mbrojtur titullin. Nuk vijnë lajme të mira nga tenisti grek Stefanos Tsitsipas, numri 3 në botë. Ai ndodhet në Sidney dhe po luan në ATP Cup, por ka probleme me bërryllin, çka mund ta detyrojë të tërhiqet në momentin e fundit. "Dua të luaj, por nuk e kam vendosur ende. Kam ende dhimbje dhe po ndjek këshillat e mjekut. Shpresoj të rikuperoj gjatë këtyre dy javëve që kanë mbetur dhe të luaj normalisht në Melburn", ka thënë Tsitsipas.

## 'El Clasico' për Haalandin

MADRID, 4 JANAR - Erling Haaland është një nga lojtarët që po përflitet shumë në këtë merkato. Zëra të shumtë e lidhin sulmuesin e Dortmundit me skuadrën e Real Madrid dhe, siç duket, e ardhmja e 24-vjeçarit qenka e lidhur

ngushtë me kampionatin spanjoll. Një nga golashënuesit më të mirë të futbollit evropian ka vënë në garë dy skuadra gjigante të La Ligës. Një "El Clasico" në mes të Real Madridit dhe Barcelonës do të shikojmë në këtë

merkato dhe "lufta" mes dy ekipeve për transferimin e sulmuesit norvegjez do të jetë e ashpër. Sipas "Marca", Barcelona ka nisur bisedimet me agjentin e lojtarit, Mino Raiola, për të transferuar Haaland në "Camp

Nou". Në këtë duel më i avantazhuar duket "Los Blankos" për shkak edhe të situatës ekonomike që ka për momentin, por gjithsesi Joan Laporta ka premtuar një goditje "big" për sulmin e skuadrës së Xavi



Hernandezit dhe Haaland mund të jetë lojtari "Big" i premtuar.

## Ancelotti: Italia e sigurt me Mançinin, ja kush e fiton Serinë A

MADRID, 4 JANAR - Real Madridi e filloi vitin 2022 me humbjen 1-0 në fushën e Getafes, duke u dhënë fund 11 rezultateve pozitive radhazi në La Liga, aty ku kryeson me 5 pikë më shumë se Sevilla (ka luajtur një ndeshje më pak). Trajneri i ekipit madrilen, Carlo Ancelotti, ka prekur disa tema të ndryshme në intervistën e dhënë për "Il Messaggero", aty ku shprehet i bindur se Italia do të kualifikohet në Botërorin e Katarit. Kampionët në fuqi të Evropës duhet të fitojnë në muajin mars kundër Maqedoninë së Veriut dhe më pas ndaj fituesit të çiftit Portugali - Turqi për të siguruar një biletë për në Katar. "Humbja ndaj Getafës erdhi për disa shkaqe, si Covidi dhe dëmtimet, por skuadra ime është solide, e kemi treguar edhe më parë në dhjetë fitoret radhazi. Le të themi se ishim ende me pushime", ka thënë Ancelotti, i cili pati një koment edhe për Serinë A. "Shoh Interin



si ekipin favorit për fitimin e titullit. Simone Inzaghi ia ka dalë të mos ndihen largimet e Lukakut dhe Hakimit", ka shtuar ai. Trajneri Carlo Ancelotti e lavdëroi edhe trajnerin e Italisë, Roberto Mançini, duke thënë se Italia është e sigurt me

Mançinin në krye. "Mançini do të na kualifikojë në Katar 2022. Të mbetemi dy herë radhazi jashtë një Botërori do të ishte një goditje e madhe për Italinë, sidomos pas suksesit të madh në 'Euro 2020', ka deklaruar Mançini.

## Golden State nuk ndalet, humb Milwaukee dhe Brooklyn

SAN FRANCISCO, 4 JANAR - Skuadra e Golden States ruan kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit në NBA pas fitores 115-108 ndaj Miami. Poole me 32 pikë ishte më i miri për vendasit, mbështetur edhe nga Wiggins me 22 pikë. Zhgënjën skuadra e Brooklynit, që në fushën e saj u mund 118-104 nga Memphis. Moranti realizoi 36



pikë dhe Bane 29, një dyshe që bëri dallimin në fushë për miqtë, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Durantit për vendasit. Edhe skuadra kampione e Milwaukee ka dalë e humbur sot, pasi u

mposht 115-106 nga Detroiti. Bey realizoi 34 pikë për miqtë, mbështetur edhe nga Jacksoni me 24 pikë, ndërsa për Bucksin u dallua Giannisi me 31 pikë e 10 rebounde, por që mbetën për statistikë.

### REZULTATET

Philadelphia - Houston	133-113
Washington - Charlotte	124-121
Brooklyn - Memphis	104-118
Chicago - Orlando	102-98
Milwaukee - Detroit	106-115
New Orleans - Utah Jazz	104-115
Dallas - Denver	103-89
Golden State - Miami	115-108
Portland - Atlanta	136-131
Clippers - Minnesota	104-122

### SHKURT

#### Cagliari interesohet për Bajramin

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Nedim Bajrami, është duke kaluar nëpër një formë fantastike në Serinë A. Skuadra e Cagliarit është në kërkim të përforcimeve në afatin kalimtar të janarit teksa objektivi kryesor ka mesfushorin shqiptar. Megjithatë, Empoli për ta lënë të lirë Bajramin është duke kërkuar 11 milionë euro, shkruan "Tuttomercatoweb". Bajrami me Empolin në këtë sezon ka zhvilluar 22 paraqitje, teksa ka shënuar gjashtë gola dhe ka asistuar katër të tjerë.

#### Buffoni rezulton pozitiv me Covid

Portieri Gianluigi Buffon është infektuar me Covid-19. Lajmin e ka bërë me dije skuadra e Parmës, kurse Buffoni është i vetmi që ka rezultuar pozitiv. Buffoni ka bërë 18 paraqitje në Serinë B për Parma deri më tani këtë sezon, duke e mbajtur gjashtë ndeshje portën e paprekur dhe duke pritur tri penallti.

#### Mbappe arrin shifrën e 200 golave

Kylian Mbappe ka arritur në shifrën e 200 golave në karrierë. Sulmuesi francez e ka bërë këtë gjë teksa ende është vetëm 23-vjeçar. Në ndeshjen ndaj Vennes në kuadër të Kupës së Francës, Mbappe realizoi tre gola për të shkuar në shifrën e 201 golave gjithsej. Ai i ka realizuar 150 gola me Paris Saint-Germainin, 27 me Monaco dhe 24 me ekipin kombëtar të Francës. Këtë shifër Mbappe e arriti në 309 ndeshje sa i ka zhvilluar gjithsej. Mbappe erdhi në Paris Saint-Germainin në vitin 2018, duke treguar performanca të jashtëzakonshme, ndërsa në verë pritet të transferohet në Real Madrid.

#### Malcuit infektohet me Covid

Mbrojtësi i skuadrës së Napolit, Kevin Malcuit, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Këtë lajm e ka publikuar vetë klubi napolitan me anë të kanaleve zyrtare teksa sqaron se edhe Andrea Patenga ka përfunduar periudhën e vetizolimit dhe ka dalë negativ nga virusi SARS-COV-2. Në komunikatën e klubit të kaltër thuhet se të dy lojtarët kanë qenë totalisht të vaksinuar me të dyja dozat dhe Malkui është totalisht asimptomatik dhe do t'i ndjekë me përpikëri rregullat e protokollit anti-Covid duke u vetëkarantinuar në banesën e tij.

#### Osaka rikthehet me fitore pas 4 muajsh, Tsitsipas në dyshim për Australian Open

Më 17 janar do të nisë në Melburn grand slam i Australian Openit dhe tenistët janë duke bërë përgatitjet e fundit. Pothuajse të gjithë tenistët ndodhen në Australi, ku po marrin pjesë në disa turne të vegjël. Në fushë është rikthyer pas katër muajsh pushim ish-numri një në botë, tenistja japoneze Naomi Osaka. Ajo është kampione në fuqi e Australian Open, por muajt e fundit kaloi një krizë psikologjike dhe nuk luajti. Në turneun e Melburn Summer Set, ajo fitoi 2-1 (6-4, 3-6, 6-3) ndaj francezes Aize Cornet. Kjo është fitorja e parë e Osakës pas 4 muajsh dhe duket se do të luftojë deri në fund për ta mbrojtur titullin. Nuk vijnë lajme të mira nga tenisti grek Stefanos Tsitsipas, numri 3 në botë. Ai ndodhet në Sidney dhe po luan në ATP Cup, por ka probleme me bërryllin, çka mund ta detyrojë të tërhiqet në momentin e fundit. "Dua të luaj, por nuk e kam vendosur ende. Kam ende dhimbje dhe po ndjek këshillat e mjekut. Shpresoj të rikuperoj gjatë këtyre dy javëve që kanë mbetur dhe të luaj normalisht në Melburn", ka thënë Tsitsipas.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Koca Law Office” L.L.C. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr: 811861097 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Koca Law Office” L.L.C. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr: 811861097 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Koca Law Office” L.L.C. Pristine. has come to the decision to quit its business: 811861097 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Besarta Bardoniqi Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

► Elizabeta Sabri Islami shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të parë dhe të dytë të shkollës së mesme Ekonomike drejtimi Juridik Prishtinë.

► Liridon Rexhaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl II dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Votin Kolukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Heronjtë e Lumes" Vermicë.

► Dyze Daqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Shtjefen Gjeqovi" Zym.

► Ilami Susuri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

► Mert Artan shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Emin Duraku" Prizren.

► Arian Bobaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHFMU "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

► Uran Shala shpall te pavlefshme certifikatën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

